



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

D E K R E T

“PËR

PROPOZIMIN E KRYETARIT TË KONTROLLIT TË LARTË TË
SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 162, pika 2 dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 19 pika 2, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

D e k r e t o j

Neni 1

Zoti Petraq Milo i propozohet Kuvendit të Shqipërisë për t’u zgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Nr. Dekretit 11229
Tiranë, më 17.07.2019


PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



J. Y. Pashaj
10.05.2019
Pashaj
1
Nr. 2402/1 Prot.

Tiranë, më 17.07.2019

Lënda: Dërgohet dekreti i Presidentit të Republikës për propozimin e zotit Petraq Milo për tu zgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 162 pika 2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 19 pika 2, të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me Dekretin nr. 10929, datë 05.11.2018, i propozoi Kuvendit të Shqipërisë që zonja Vitore Tusha, të zgjidhet në detyrën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kuvendi i Shqipërisë, pasi shqyrtoi këtë propozim me Vendimin nr.126, datë 20.12.2018, ka vendosur: “Mosmiratimin e kandidaturës së zonjës Vitore Tusha dhe rrëzimin e dekretit nr. 10929, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Ky vendim është përcjellë nga Kuvendi në institucionin e Presidentit të Republikës, me shkresë nr.3553/2 prot, datë 24.12.2018.

Pas njohjes me Vendimin nr.126, datë 20.12.2018 të Kuvendit të Shqipërisë, Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 11063, datë 19.01.2019, i propozoi Kuvendit të Shqipërisë kandidaturën e z. Bahri Shaqiri për t’u zgjedhur në pozicionin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr.25, datë 31.01.2019, vendosi: “Mosmiratimin e kandidaturës të zotit Bahri Shaqiri dhe rrëzimin e dekretit nr. 11063, datë 19.01.2019 të Presidentit të Republikës “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Ky vendim është përcjellë nga Kuvendi me shkresë nr.234/1 prot, datë 01.02.2019 në institucionin e Presidentit të Republikës.

Presidenti i Republikës, ka lexuar me shumë vëmendje sugjerimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë lidhur me profilin profesional që duhet të ketë kandidati për Kryetar të KLSH-së dhe për këtë, Presidenti i Republikës vlerëson se, Prof. Dok. Petraq Milo është kandidati më i përshtatshëm dhe me eksperiencë të gjithanshme për të përmbushur me profesionalizëm dhe dinjitet këtë detyrë tepër të rëndësishme kushtetuese.

Bazuar në këtë bindje, si dhe mbështetur në faktin që kandidatura e zotit Petraq Milo plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për t'u emëruar në këtë pozicion, Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 11229, datë 17.07.2019, ka vendosur t'i propozojë Kuvendit të Shqipërisë që z. Petraq Milo të zgjidhet në pozicionin kushtetues të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Prof. Dok. Petraq Milo është një personalitet me një eksperiencë të jashtëzakonshme brenda dhe jashtë vendit në fushën e financave, të auditit, të bankave dhe të ekonomisë në tërësi me një kontribut të spikatur në drejtimin e institucioneve financiare, fiskale e bankare në Kosovë.

Përvoja e tij akademike brenda dhe jashtë vendit, si edhe bashkëpunimi me institucionet më të rëndësishme financiare botërore dhe të Bashkimit Europian, janë një faktor i rëndësishëm për këtë zgjedhje të Presidentit të Republikës.

Presidenti i Republikës shpreh besimin e plotë se, Kuvendi i Shqipërisë do ta shqyrtojë këtë kandidaturë brenda këtij sesiioni parlamentar, me objektivitet dhe me përgjegjshmëri, në mënyrë që institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit të funksionojë në përmbushje të plotë të detyrave të tij kushtetuese e ligjore.

Refruar sa më sipër, bashkëlidhur po Ju përcjellim dekretin e Presidentit të Republikës SH.T.Z. Ilir Meta, nr.11229, datë 17.07.2019, me të cilin i propozohet Kuvendit të Shqipërisë që Zoti Petraq Milo të zgjidhet në funksionin kushtetues të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe dokumentacionin përkatës të dorëzuar nga zoti Milo, administruar pranë Institucionit të Presidentit të Republikës.

Ju faleminderit!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

ORNELA ZONJA

